

VENDIM
Nr. 66, datë 29.1.2025

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2025, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR ORGANIZIMIN E KONGRESIT BOTËROR
TË SË DREJTËS 2027, NË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2025, në zërin “Shpenzime korrente”, të programit “Planifikim, menaxhim, administrim”, i shtohet fondi prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, për pagimin e kuotës për organizimin e Kongresit Botëror të së Drejtës 2027, në Tiranë.

2. Fondi sipas pikës 1, të këtij vendimi, prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2025.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku